

SPECIFIKIME TEKNIKE

OBJEKTI: KULLË ROJE VROJTIMI NË PLAZHIN E VELIPOJËS

Për realizimin e kullave të vrojtimit duhet të përdoret dru bredhi i pastruar dhe leviguar me letër abrazive 180. Pastaj duhet të aplikohen mbi materialin e drurit imprenjant ose vajra mbrojtës (vaj lini prsh) disa duar derisa druri të ngopet, për të arritur kështu një mbrojtje maksimale të drurit nga agjentët atmosferik. Mbrojtja nëpërmjet imprenjantit ose vajrave bën të mundur mirëmbajtjen më të lehtë të drurit me kalimin e kohës, pasi do të mjaftojë levigimi me letër abrazive i papastërtive, dhe pastaj lyerja me imprenjant të tipit transparent, një ose dy duar.

Intervalet e mirëmbajtjes së strukturës së drunjtë duhet të bëhen çdo vit. Çfarëdo trajtimi që i bëhet drurit duhet të respektojë drejtimin e fibrave të drurit. Druri në fakt është një material jo-homogjen i orientuar nga fibrat e tij, drejtimi i të cilave është i dukshëm nga venaturat e tij. Çdo aplikim i bërë mbi drurin duke ndjekur drejtimin e venaturave do të penetrojë më në thellësi, do të thahet më parë dhe do të shpërndahet në mënyrë më uniforme.

Mbrojtja më e mirë dhe ekonomike e drurit është vaji: një element igroskopik që nuk përzihet dhe që largon ujin, shkakun kryesor të degradimit të drurit të ekspozuar ndaj agjenteve atmosferik, është gjithashtu komplet kompatibël me celulozën.

Pasi të jetë skuadruar dhe përgatitur, drurit i jepet një dore vaji e hollë por uniforme duke ngjyer një tampon. Tamponi është mjeti më i mirë për të lyer drurin me vaj mbrojtës.

Është e preferueshme të përdoren tamponet komercial që janë të përbërë nga një shtresë e hollë cope natyrale ose sintetike e fiksuar mbi një mbajtëse të fortë e pajisur me dorezë.

Është e preferuar të përdoret vaji i linit ose të ngjashëm me të. Vaji përveçse është shumë më ekonomik dhe eko-kompatibël, ai gjithashtu e mbron drurin në mënyrë më efektive se materialet sintetike. Si përfundim vlen të theksohet se mbrojtja e drurit me bazë vajin ekzalton venaturat dhe stonalizimet e drurit, duke i dhënë një efekt të theksuar estetik drurit të përdorur.

Montimi dhe fiksimi i elementëve të drunjtë do të bëhet nëpërmjet vidave, për të siguruar një strukturë sa më të fortë dhe të qëndrueshme sidomos ndaj rrymave të forta të erës që janë karakteristike përgjatë vijës bregdetare, sidomos gjatë periudhës së dimrit.

Specialist

Ark. Julian VECAJ